

VENDIM
Nr.824, datë 6.12.2006

PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8, e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Institucionet, që autorizohen për verifikim, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, janë:

1. Zyra e Presidentit të Republikës;
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
3. Prokuroria e Përgjithshme;
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
5. Ministria e Drejtësisë;
6. Ministria e Brendshme;
7. Ministria e Mbrojtjes;
8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
9. Ministria e Punëve të Jashtme;
10. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabara;
11. Ministria e Financave;
12. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
13. Shërbimi Informativ i Shtetit;
14. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
15. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
16. Interpoli;
17. Garda e Republikës;
18. Departamenti i Administratës Publike;
19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
20. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
21. Përfaqësitë diplomatike, me autorizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
22. Banka e Shqipërisë;
23. Përfaqësia e Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë;
24. Përfaqësia e Këshilit të Europës në Republikën e Shqipërisë;
25. Përfaqësia e NATO-s në Republikën e Shqipërisë.

II. Miratimin e formularit të vetëdeklarimi, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe subjektet e tjera, që përcaktuara në këtë vendim, të caktojnë personin përkatës, që do të ketë akses për të përfutur të dhënat e parashikuara në pikën 8 të nenit 2 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes civile gjyqësore”, brenda një afati prej 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri Atësia/Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër, mbiemër/firmë

Emër, mbiemër/firmë / vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.